

li i Xhemiles, Qaushi, dhe djali i vëllait të Saliut, Fitimi, erdhën deri tek oborri ku e gjetën Xhemilen të plagosur rëndë. Shtëpia ishte e djegur. E bartën në fushën e afërt. Së shpejti dha shpirt. Në mbrëmje, rreth orës 22:00, e kanë varrosur në livadhin e quajtur *Desku*. Në muajin qershor të vitit 2000, mbetjet mortore të Xhemiles janë rivarrosur në varrezat e Cerrovikut/Cerovik.

**Burimet:** deklarata S.J, FDH-19325; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 117, FDH-23857; *Bodies of Two More Albanians Killed by Serb Forces in Drenica Found*, pasqyra e lajmeve, KIC, 3.10.1998, FDH-29722.

## Saša (Đorđe) Miljković

(16.06.1975, serb nga Izvori/Izvor, komuna e Novobërdës/Novo Brdo, pjesëtar i UJ-së)

Saša ka qenë ushtar me kontratë pranë Brigadës së 125 të Motorizuar të Ushtrisë së Jugosllavisë. Në datën **26.10.1998**, gjatë turnit të tij në kontrollimin e rojës në fshatin **Vulljakë/Volujak**, të cilën e bënte në cilësinë e eprorit të rojës, mbi të ka shtënë gabimisht një ushtar, i cili gjendej në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak dhe i cili nuk e njohu eprorin e vet. Saša ishte plagosur në stomak dhe gju. E çuan menjëherë në spitalin e Gjakovës/Đakovica ku, në të njëjtën natë, dha shpirt nga plagët e rënda. E kanë varrosur në fshatin e lindjes.

**Burimet:** deklarata M.Đ, FDH-9181; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 44; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KMKRKF, *Personat...*, FDH-10832; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović i dhe të tjerë), EX.3D01012, FDH-31347.

## Sejdi (Fazli) Shala

(5.03.1964, shqiptar nga Kopiliqi i Ulët/Donji Obilić, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Sejdiu ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Në të njëjtin njësit me të ishte edhe i vëllai Shefkiu. Në datën **5.11.1998**, rreth orës 9:00, Sejdiu u nis në mullirin e *Çupevës/Çupevo* në **Jashanicë/Jošanica**, që të ngarkonte miell për UÇK-në. Ka shkuar me automobilin e tipit *Tojota* të ngjyrës së bardhë. Pas disa orësh, nga drejtimi i Jashanicës/Jošanica u dëgjuan disa të shtëna. Po atë ditë, Shefkiu ka mësuar nga disa gra të Jashanicës/Joša-

nica se Sejdiu ka rënë gjatë konfliktit me policinë serbë. Policia e ka çuar trupin e Sejdiut në drejtim të Pejës/Peć. Me vite të tëra, familjarët nuk dinin çfarë ka ndodhur me trupin e Sejdiut. Vetëm në muajin shtator të vitit 2003, ata u njoftuan zyrtarisht se mbetjet mortore të Sejdiut janë zhvarrosur nga varrezat e Pejës/Peć. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Sejdiut në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Kopiliq të Ulët/Donji Obilić [Skënderaj/Srbica].

**Burimet:** deklarata Sh.S, FDH-32446; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.1.4, FDH-30924.

## Ilmi (Sadri) Aliu

(25.10.1964, shqiptar nga Izbica, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, pjesëtar i UÇK-së)

Ilmiu ka qenë mashkulli më i madh në familjen Aliu. I ati Sadriu i punonte në Zvicër, nga ku me dërgesa parash e financonte familjen e vet në Izbicë/Izbica. Nga viti 1993, familja Aliu ka filluar të furnizohet me armatim. Ilmiu i kaloi tre muaj në burg gjatë vitit 1994, ngase policia pati zbuluar disa armë në shtëpinë e tij. Pas daljes nga burgu, Ilmiu ka shkuar në Zvicër. Në muajin nëntor të vitit 1997, Ilmiu u angazhua në mbledhjen e ndihmës për forcat e UÇK-së, ndërkaq në Kosovë u kthye më 2.04.1998. Pas pak, aderoi edhe zyrtarisht në radhët e UÇK-së. Në mëngjesin e datës **5.11.1998**, Ilmiu me dy bashkëluftëtarë u nisën për në **Jashanicë/Jošanica**. Donin të ndihmonin në thyerjen e bllokadës së forcave serbe përreth mullirit të *Çupeves/Çupevo*, me anë të cilës pjesëtarë të forcave serbe nuk u lejonin shqiptarëve që të furnizoheshin me miell. Menjëherë pas arritjes në fshat, Ilmiu dhe bashkëluftëtarët e tij u ndeshën me policët serbë. Një plumb e qëlloi Ilmiun në kokë dhe e la të vdekur në vend. Në të njëjtën mbrëmje, bashkëluftëtarët e çuan trupin e pajetë të Ilmiut te familja. Një ditë më vonë, ai u varros në varrezat e Izbicës/Izbica.

**Burimet:** deklarata S.A, FDH-32790; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; *Dnevnik od 4. do 10. novembra*, Ilustrovana politika, 14.11.1998, FDH-32279.